**URDHËR**
**Nr. 660, datë 23.6.2026**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 1324, DATË 4.12.2025, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E LITUANISË"**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1324, datë 4.12.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Lituanisë".
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Andis Salla**